

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, ne çështjen penale ndaj të pandehurës D.K nga Gjilani, për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-s, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.1936/2021 të datës 01.12.2021, të cilën e përfaqëson prokurori Sllavica Popoviq, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 13.04.2022, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura **D.K** nga i ati B. dhe nënës M. e lindur K, e lindur më.., në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme, me numër..., me vendbanim në Gjilan, e pa martuar, punon si menagjere në kafiterinë “Kafe Bar te Kujtimi”, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e R. të Kosovës, më parë e pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj saj.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse më datë 17.11.2021 rreth orës 15,20 minuta, në Gjilan në rrugën ..në kafiterinë “K....”, e pandehura D.K me dashje dhe me qëllim nuk ka zbatuar urdhërin e ligjshëm të AUV-it, duke hequr shenjën zyrtare në hyrjen kryesore të lokalit në fjalë, në atë mënyrë që përkundër se me datë 11.11.2021 për shkak të zhvillimit të veprimtarisë pa licencë dhe në kundërshtim me ligjin Sanitar 2003/22 nga AUV, ishin vendosur shenja zyrtare për mbylljen e lokalit në hyrjen kryesore me mbishkrim “NDALOHET PËRKOHSISHTR VEPRIMTARIA”e pandehura e heq dhe e dëmton shenjën zyrtare dhe hynë në local dhe zhvillon veprimtarinë pa përfillur ndalesën përkundër se është e vetëdijshme se një veprim I tillë është 9i kundërligjshëm.

Me çka ka kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartë cekur ligjore dhe nenit 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72, 76 dhe 79 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurën:

E G J Y K O N

I. Të pandehurës D.K, për vepër penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK -s, i shqipton denim me gjobë në shumë prej 300 (treqind euro) të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Obligohet e pandehura që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 (njëzetë e pesë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe deklarimi i palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.12.2021, ka ngritur aktakuzën PP.II.1936/2021, kundër të pandehurës. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit e pandehura **D.K** deklaroi se e pranonë fajësinë për veprën e kryer siq është përshkruar në dispozitivin të aktakuzës.

Prokurori i Shtetit Sllavica Popoviq, deklaroi: meqenëse e pandehura në këtë shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë, në tërësi mbetem pranë këtij akti akuzues me të gjitha propozimet që i përmban kjo aktakuzë dhe i propozoj gjykatës që të pandehurën në fjalë ta shpallë fajtores dhe ta dënojë me denim meritor sipas ligjit duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës AUV – zyra regjionale në Gjilan L. M, në fjalën përfundimtare deklaroi: i bashkangjitem ndjekjes penale dhe paraqes kërkesë pasurore – juridike ndaj të pandehurës.

E pandehura D.K, në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndijë veten fajtores dhe jam penduar shumë për këtë veprë që e kam kryer më parë nuk kam kryer vepra penale dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë të tillë dhe të tjera penale dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit të dëmtuarës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurës D.K për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehura nuk ka qenë e detyruar as e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të këtyre veprave penale, ekziston fakti se e pandehura D.K ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK -s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtores të akuzuarën D.K për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK -s, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjëse.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe të njëjtës ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të të akuzuarën D.K si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se e akuzuara ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata merr për bazë lëndimet trupore, frikën dhe shqetsimin emocional të dëmtuarës, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurës.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës D.K duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e saj, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për kërkesën pasurore-juridike

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurën ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 998/2021-Më 13.04.2022

Sek. Juridike

Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtar,

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurës në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, P; rfaqesuesit të dëmtuarës dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

NË EMËR TË POPULLIT
A K T G J Y K I M

E pandehura **D.K** nga i ati Burim dhe nënës Merrushe e lindur Kryeziu, e lindur më 06.06.2002, në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme, me numër 1242316939, me vendbanim në Gjilan, në Lagjën “Arbëria” Rr. "Xhemajl Ymeri" nr.6, e pa martuar, punon si menagjere në kafiterinë “Kafe Bar te Kujtimi”, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e R. të Kosovës, më parë e pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj saj.

ËSHTË FAJTORE

Sepse më datë 17.11.2021 rreth orës 15,20 minuta, në Gjilan në rrugën “Xhemajl Ymeri”, në kafiterinë “kafe bar te Kujtimi”, e pandehura D.K me dashje dhe me qëllim nuk ka zbatuar urdhërin e ligjshëm të AUV-it, duke hequr shenjën zyrtare në hyrjen kryesore të lokalit në fjalë, në atë mënyrë që përkundër se me datë 11.11.2021 për shkak të zhvillimit të veprimtarisë pa licencë dhe në kundërshtim me ligjin Sanitar 2003/22 nga AUV, ishin vendosur shenja zyrtare për mbylljen e lokalit në hyrjen kryesore me mbishkrim “NDALOHET PËRKOHSISHTR VEPRIMTARIA” e pandehura e heq dhe e dëmton shenjën zyrtare dhe hynë në local dhe zhvillon veprimtarinë pa përfillur ndalesën përkundër se është e vetëdijshme se një veprim I tillë është 9i kundërligjshëm.

Me çka ka kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartë cekur ligjore dhe nenit 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72, 76 dhe 79 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurën:

E G J Y K O N

I. Të pandehurës D.K, për vepër penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK -s, i shqipton denim me gjobë në shumë prej 300 (treqind euro) të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Obligohet e pandehura që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 (njëzetë e pesë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 13:50 min.

V e r t e t o j n e

Sek. juridike,

G j y k a t e s i

